



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA AUDITIMIT**

Nr. 278 prot.

Elbasan, më 19.01.2021.

**M I R A T O I**  
**Kryetari i Bashkisë**  
**z.Gledian LLATJA**

**KODI I ETIKËS PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM**  
**BASHKIA ELBASAN**

**Përkufizimi i AB**

Sipas Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm, pjesë e Kornizës së Praktikave Profesionale të IIA, auditimi i brendshëm është një aktivitet siguridhënie dhe këshillimi, i pavarur dhe objektiv, i krijuar për të vendosur besimin dhe sigurimin objektiv për të shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e organizatës. Auditimi i brendshëm ndihmon që organizata të përmbushë objektivat e saj me anë të një përqsasjeje sistematike dhe të disiplinuar në vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes.

**Mbi profesionin e AB**

Auditimi i brendshëm është një profesion dinamik dhe mjaft interesant pasi të jep mundësi të panumërta për t'u zhvilluar profesionalisht dhe për të dhënë një kontribut të dukshëm në të gjitha nivelet organizative. Audituesi i brendshëm nisur nga përkufizimi luan rolin e një partneri të rëndësishëm dhe ndihmon organizatën në përmbushje të objektivave. Profesionistët që veprojnë në fushën e auditimit të brendshëm kanë një kuptim të thellë të kulturës, sistemeve dhe proceseve në kryerje të aktiviteteve. Kështu, ata mund të drejtojnë aktivitetin e auditimit të brendshëm dhe të japë siguridhënien e duhur që:

- Kontrollat e brendshme janë të mjaftueshme për të zvogëluar risqet;
- Proceset e qeverisjes janë efektive dhe efçente, si dhe;
- Objektivat organizative janë arritur.

Për këtë, audituesve të brendshëm u duhet të vlerësojnë teknologji të reja; të shqyrtojnë çështje dhe problematika globale; të analizojnë risqe, kontrole, dilema etike, cilësi dhe efçencë; të japin siguridhënie që kontrollet ekzistuese janë të mjaftueshme për të

zvogëluar risqet; të komunikojnë me qartësi dhe saktësi. Një diversitet i tillë u jep audituesve të brendshëm një perspektivë të gjerë mbi organizatën. Për më tepër, i bën ata të jenë një burim i vlefshëm për menaxhimin ekzekutiv dhe bordin drejtues duke i ndihmuar këta të fundit në përmbushjen e objektivave si dhe në forcimin e kontroleve të brendshëm dhe qeverisjes organizative.

Në fushën e veprimit, për të gjithë audituesit e brendshëm të certifikuar në detyrë, shkeljet e Kodit të Etikës do të vlerësohen dhe administrohen sipas akteve ligjore në fuqi.

## PARIMET E KODIT TË ETIKËS

Auditorët e brendshëm priren të aplikojnë dhe mbështesin parimet e mëposhtme:

### • *Integriteti*

Integriteti i auditorëve të brendshëm krijon besimin dhe në këtë mënyrë siguron bazën për mbështetje të gjykimit të tyre.

### • *Objektiviteti*

Auditorët e brendshëm shfaqin nivelin më të lartë të profesionalizmit gjatë mbledhjes, vlerësimit dhe komunikimit të informacionit në lidhje me aktivitetin ose procesin që është duke u shqyrtuar dhe audituar. Auditorët e brendshëm duhet të bëjnë një vlerësim të balancuar të të gjitha rrethanave përkatëse në nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve dhe nuk duhet të jenë të ndikuar padrejtësisht nga interesat e tyre personale, ose nga të tjerët në formimin e gjykimeve.

### • *Konfidencialiteti*

Auditorët e brendshëm të respektojnë vlerat dhe pronësinë e informacionit që ata marrin dhe të mos zbulojë informacionin e marrë pa autoritetin e duhur nëse nuk ka një detyrim ligjor ose profesional për ta bërë këtë.

### • *Kompetenca*

Auditorët e brendshëm aplikojnë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e nevojshme të kërkuar në kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm.

## RREGULLAT E SJELLJES TË KODIT TË ETIKËS

### 1. *Integriteti*

Auditorët e brendshëm:

- 1.1. Do të kryejnë punën e tyre me ndershmëri, përkujdesje dhe përgjegjësi.
- 1.2. Duhet të respektojnë ligjin dhe të bëjnë dhënien e informacioneve shpjeguese të udhëhequra sipas ligjit dhe profesionit.
- 1.3. Nuk duhet me vetëdije të jetë palë në ndonjë aktivitet të paligjshëm, ose të angazhohen në veprime që janë diskredituese për profesionin e auditimit të brendshëm, ose për organizatën.

- 1.4. Duhet të respektojnë dhe të kontribuojnë në objektivat legjitime dhe etike të njësisë publike (organizatës).

## **2. Objektiviteti**

Auditorët e brendshëm:

- 2.1. Nuk do të marrin pjesë në ndonjë aktivitet ose marrëdhënie që mund të dëmtojë ose parashikon dhe supozuar të dëmtojë vlerësimin e tyre të paanshëm. Kjo pjesëmarrje përfshin ato aktivitete ose marrëdhënie që mund të jenë në konflikt me interesat e organizatës.
- 2.2. Nuk do të pranojë asgjë që mund të pengojë ose supozohet që të pengojë gjykimin e tyre profesional në vendimmarrje.
- 2.3. Do të zbulojnë të gjitha faktet materiale të njohura për ata që, nëse nuk zbulohet, mund të shtrembërojnë raportimin e aktiviteteve në shqyrtim të procesit nën auditim.

## **3. Konfidencialiteti**

Auditorët e brendshëm:

- 3.1. Duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit të mbledhur gjatë veprimtarisë në kryerjen e detyrave të tyre.
- 3.2. Nuk duhet të përdorin informacionin për ndonjë përfitim personal, ose në ndonjë mënyrë që do të ishte në kundërshtim me ligjin ose i dëmshëm për objektivat legjitime dhe etike të organizatës.

## **4. Kompetencat**

Auditorët e brendshëm:

- 4.1. Do të angazhohet vetëm në ato shërbime (veprimtarinë audituese) për të cilat ata kanë njohur të nevojshme, kompetencë, aftësi dhe përvojën e duhur.
- 4.2. Do të kryejnë shërbime të auditimit të brendshëm në përputhje me kuadrin ligjor, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.
- 4.3. Duhet vazhdimisht të përmirësojnë aftësitë, efektivitetin dhe cilësinë e shërbimeve të tyre profesionale.

### **Konceptoi;**

Drejtoria e Auditit të Brendshëm  
Drejtor Gëzim Paja